



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE**  
**LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**  
**KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 44, datë 14.10.2016**

**LICENCIM PËR HERË TË PARË PËR**  
**SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME VORË**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Vorë me:

Drejtues Ligjor Aldo Sheshaj

Drejtues Teknik Agim Koraqe

2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Vorë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia: Vorë

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË  
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr. 21, datë 19.04.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR  
NR. 44, DATË 14.10.2016 PËR “LICENCIMIN PËR HERË TË PARË PËR SH. A  
UJËSJELLËS KANALIZIME VORË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 19.04.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vorë sh.a. (**UK Vorë**) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik.”,

**Vëren se:**

1. Shoqëria UK Vorë me shkresën nr. 289 prot. datë 26.03.2019, me lëndë “Kërkesë për ndryshim licence” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.
3. ERRU ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin për herë të parë për sh. a Ujësjellës Kanalizime Vorë”, (**vendimi i KKRR nr. 44**) me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Vorë sh.a. plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi profilin e edukimit.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin për herë të parë për sh. a Ujësjellës Kanalizime Vorë” bëhet ndryshimi si më poshtë:

*“Drejtues Teknik Majlinda Bylykbashi”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Ndriçim Shani**